



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Z. Ramë Buja
Ministër i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Rr. “Agim Ramadani”, p.n.
10000 Prishtinë, Kosovë

KËRKESË URGJENTE PËR MASË TË PËRKOHSHME

Ex officio

Rasti nr. 518/2014

I nderuar z. Ministër Buja,

Avokati i Popullit, bazuar në nenin 15 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Nr. 03/L-195, ka hapur hetime me vetiniciativë (*ex-officio*) në lidhje me ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e Vendimit nr. 178/01B, të datës 13 nëntor 2014, *Për regjistrimin e fëmijëve të kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” në vitin akademik 2014/2015*. Në këtë vendim Ju kërkoni nga Rektori i Universitetit të Prishtinës që: “*Të regjistrohen fëmijët e kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së . . . të cilët i janë nënshtruar provimeve pranuese sipas afateve zyrtare të shpallura nëpërmjet konkurseve për vitin akademik 2014/2015*” (*id.*, par. 1-2). Për më tepër, vendimi përcakton se: “*Në pamundësi eventuale që të regjistrohen në programe ku kanë aplikuar, të regjistrohen në programe të përafërta*” (*id.*, par. 3).

Me anë të kësaj letre, po Ju drejtohem me rekomandim që të pezulloni ekzekutimin e këtij vendimi, deri në përfundimin e hetimeve nga ana e Avokatit të Popullit. Ky rekomandim nuk paragjykon në asnjë mënyrë meritat e çështjes ose rezultatet e këtyre hetimeve.

Rekomandimi bazohet në nenin 16, par. 5, të Ligjit për Avokatin e Popullit, i cili përcakton se: “*Nëse gjatë hetimeve, Avokati i Popullit konstaton se ekzekutimi i ndonjë vendimi administrativ mund të ketë pasoja të pariparueshme për personin fizik apo juridik, mund të rekomandojë që autoriteti kompetent ta pezullojë ekzekutimin e vendimit në fjalë deri në përfundimin e hetimeve lidhur me këtë çështje nga ana e Avokatit të Popullit.*”

Ky kriter është përmbushur qartazi në rastin konkret. Më 14 nëntor 2014, Avokati i Popullit u takua me Rektoren e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Ramadan Zejnullahu. Në këtë takim, Rektori ka shpjeguar se Universiteti i Prishtinës nuk ka kushte për rritjen e numrit të studentëve për shkak se ka mungesë të stafit akademik, si dhe të laboratorëve dhe

hapësirave të domosdoshme për punë. Në të njëjtin takim Rektori Zejnullahu i dorëzoi Avokatit të Popullit një kopje të një letre që Ju kishte drejtuar juve, në të cilën ai konfirmon se “[r]ritja eventuale e numrit të studentëve do ta rëndonte procesin mësimor i cili po zhvillohet në mungesë të infrastrukturës hapësinore e laboratorike” dhe “do të ndërhynte në fillimin e vitit shkollor e si pasojë do ta dëmtonte cilësinë në procesin mësimor”. Pa paragykuar rezultatet e hetimeve, këto pohime të Rektorit paraqesin dëshmi të mjaftueshme që “ekzekutimi i [këtij] vendimi administrativ mund të ketë pasoja të pariparueshme” për studentët aktualë të Universitetit të Prishtinës.

Lidhur me këtë çështje, më 27 nëntor 2014 Kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka lëshuar një deklaratë, në të cilën pohon:

“Universiteti i Prishtinës ‘‘Hasan Prishtina’’ duhet të jetë epiqendër e dijës dhe mësimit. Studimet në të duhen vijuar nga të gjithë ata që meritojnë me punë dhe dedikim punës akademike. Kosova kurrë nuk do të harron sakrificën e veteranëve të UÇK-së dhe qeveria ime ka punuar pandërprerë që statusi i familjarëve të Dëshmorëve dhe Veteranëve të jetë i spikatur në shoqëri tonë. Megjithatë, përkrahim UP ‘‘Hasan Prishtina’’ dhe udhëheqësinë e universitetit në zbatim të përpiktë të marrëveshjeve dhe standardeve të pranimit të studentëve. Afatet kohore për regjistrim dhe mësim, kushtet e marrëveshjes paraprahe dhe e drejta ligjore e vlefshme vetëm për ata që me të vërtetë kanë nevojë dhe meritë duhen rrespektuar. Zgjidhjet duhen gjetur konform marrëveshjeve dhe afateve ligjore e jo në rrugë.”¹

Si Avokat i Popullit i Republikës së Kosovës, pajtohem me përkrahjen e Kryeministrit Thaçi për Universitetin e Prishtinës, si dhe me mirënjohjen e shprehur për sakrificat e paçmueshme jo vetëm të veteranëve, por edhe të dëshmorëve, invalidëve dhe të zhdukurve nga lufta e UÇK-së.

Në ndërkohë, mënyra më efikase për të konkretizuar përkrahjen e Kryeministrit Thaçi për Universitetin e Prishtinës si “epiqendër e dijës dhe mësimit”, është që të pezulloni ekzekutimin e vendimit tuaj, deri në përfundimin e hetimeve të plota që Avokatit të Popullit po zhvillon rreth këtij rasti.

Prandaj, z. Ministër, nisur nga gjithë sa u tha më sipër, po Ju drejtohem me kërkesë që ta ndërmerrni këtë hap të domosdoshëm.

Me nderime,


Sami Kurteshi

Avokat i Popullit

Kopje: Z. Ramadan Zejnullahu, Rektor i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”
Z. Hashim Thaçi, Kryeministër i Republikës së Kosovës

¹ Uebfaqja “Hashim Thaçi”, <https://www.facebook.com/HashimThaciOfficial>, postim i datës 27 nëntor 2014.